## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Një ankesë kundër: KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr[1] i prokurimit** | **633-23-9330-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **633-023-073-121** |

Sa i përket tenderit për: **"FURNIZIM ME MATERIAL NDERTIMOR PER RASTET EMERGJENTE.(633-023-073-121)".**

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit

*"Valmir Loshi" B.I.*

***(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)***

*Gurakoc*

***(Adresa)***

*Istog* *31000*

***(Vendi)*** ***(Kodi postar)***

*044-208 136*

***(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)***

*Valmir Loshi*

***(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)***

*loshi-design@hotmail.com*

***(Adresa elektronike)***

***13.10.2023***

***(Data e parashtrimit të ankesës)*** ***(Vënshkrimi dhe vula)***

NDERMARRJA NDERTIMORE TREGTARE LOSHI ISTOG

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____
*(Emri i avokatit)*

_____
*(Adresa e plotë)*

_____ _____
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____
*(Adresa elektronike)*

_____ _____
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

| |
|---|
| Data e njoftimit për kontratë: 01.09.2023<br>Hapja e ofertave: 21.09.2023<br>Njoftimi mbi vendimin e AK-së:03.10.2023<br>Kërkesa për rishqyrtim: 06.10.2023<br>Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 09.10.2023. |

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☐

| |
|---|
| |

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*
*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☐ **Jo** ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** [x] **Jo** ☐

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së**
**Neni 6 i LPP-së**
**Neni 7 i LPP-së**
**Neni 59 i LPP-së**
**Neni 60 i LPP-së**
**Neni 69 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne me dt. 01.09.2023 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë OE INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., ndërsa neve jemi cilësuar si tenderues i pasuksesshëm.

Kur analizohet procesverbali i hapjes dhe njoftimi mbi vendimin e AK-së, shihet që ne jemi ofertues më i lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë me çmime për njësi (totalin e njësive) ashtu siç është kërkuar. Ne kemi ofertuar me çmim prej 777.70 €, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 911.85 €, prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk është dashur dhe nuk mund të shpallet fitues i kësaj kontrate.

AK-ja nuk e ka shpallur fitues OE e rekomanduar për kontratë me çmim për njësi por me një vlerë tjetër që e ka shënuar si vlerë totale prej: 67,785.00 Euro.

Autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e saj tek letra standarde për tenderues të pasuksesshëm e ka cekur se "*Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj [nuk qe më i favorshmi nga aspekti ekonomik] [ nuk qe tenderi me çmimin më të ulët] në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*
*Ju informojmë se kontrata i është dhënë: Komisioni vlerësues pas vlerësimit, ekzaminimit konstaton se kompanitë konkurruese janë përgjegjëse, ndërsa pas krahasimit të vlerave konkuruese për njësi me sasitë e planifikuara rezulton se oferta e kompanisë* ***"Intering Construction" ka vlerë më të ulët dhe atë 67,785.00€*** *dhe është ofertë më ekonomike për autoritetin kontraktues në raport me ofertën e kompanisë "****Valmir Loshi" B.I. me ofertë 68,693.00€*** *çka do të thotë se është ofertë më joekonomike".*

Arsyeja e rekomandimit të OE **"Intering Construction** për kontratë është e paqëndrueshme sepse ne jemi ofertues me çmimin më të lirë, konform paramasës që është përpiluar dhe hartuar nga autoriteti kontraktues.

Në paramasë është kërkuar që te jepen çmimet për njësi dhe në fund është kërkuar **totali i çmimit për njësi** dhe mbi këtë bazë janë dhënë edhe çmimet nga të dy ofertuesit dhe normalisht është dashur të shpallet fituesi duke pasur parasysh çmimin për njësi.
Siç shihet edhe nga procesverbali i hapjes e edhe tek njoftimi mbi vendimin, ne jemi ofertuesi me çmimin më të ulët.
Çmimet që janë dhënë në paramasë figurojnë edhe tek **pjesa C e formularit të tenderit**, prandaj edhe fituesi duhet të shpallet duke pasur parasysh këtë çmim, e po ashtu edhe kontrata duhet të nënshkruhet me këtë çmim-totalin e çmimeve për njësi.

Sa i përket sasive të përafërta e të cilave i referohet autoriteti kontraktues duke shumëzuar me çmimin për njësi, ju sqarojmë se askund në dosje të tenderit nuk është shënuar se fituesi duhet të shpallet me çmimin e sasive të përafërta, prandaj nuk ka asnjë mundësi ligjore që të shpallet fitues një kompani duke marr parasysh vlerën e çmimit të sasive të përafërta.
Vetë fjala sasi të përafërta tregon që këto sasi nuk janë **definitive dhe përfundimtare**, prandaj nuk mund të dihet se sa sasi shkojnë apo harxhohen deri në përfundim të kontratës.

Tek kontratat kornizë, nënshkrimi i kontratës bëhet duke u bazuar në çmimin për njësi, e edhe në këtë tender nënshkrimi i kontratës duhet të bëhet me çmim për njësi, pasi që ky aktivitet i prokurimit është kontratë kornizë, madje është përcaktuar në paramasë e kjo shihet edhe te çmimet e dhëna tek formulari i tenderit, e që janë dhënë çmimet total për njësi.

Edhe tek draft kontrata e kësaj dosje shkruan qartë:
1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

Pra sasitë janë indikativë dhe si ka mundësi të nënshkruhet një kontratë me çmime për sasi indikative? Nuk ka asnjë siguri se mund të arrihet ajo vlerë e sasive indikative.

Ne me dt.09.10.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk është dhënë asnjë arsye konkrete në lidhje me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Në vendim AK-së e ka cekur si në vijim:
**"Kur ne nje aktivitet te prokurimit përshkrimi i çmimeve është kërkuar me Totalin e njësive, ne procesin e hapjes lexohen çmimet ne totalin për njësi, ndërsa kur komisioni i vlerësimit te tenderëve — vlerëson tenderët, atëherë obligohet qe ofertat financiare ti përllogarit ne: sasia e përafërt x çmimi për njësi dhe nxjerrin ofertën përgjegjëse me çmimin me te ulte".**

Me këtë konstatim, vetë AK-së e ka cekur se përshkrimi i çmimeve është kërkuar me totalin e njësive, prandaj edhe kontrata duhet të nënshkruhet me çmim për totalin e njësive dhe normalisht edhe fituesi duhet të shpallet me çmim e totalit për njësi.

Sa i përket konstatimit se komisioni i vlerësimit obligohet që të përllogariten sasia e përafërt me çmimin për njësi, ju sqarojmë se AK-së nuk ka arrit të dëshmojë se sipas cilës dispozitë obligohet komisioni i vlerësimit, por vetëm ka potencuar një gjë të tillë sepse nuk ka dispozitë ligjore që e parasheh pretendimin e tyre.
Në mungesë të argumenteve AK-së bënë konstatime sipas dëshirës së tyre.

Autoriteti kontraktues duke u munduar të arsyetojë veprimin e tyre ka përmendur edhe dy kontrata të nënshkruara në të kaluarën nga Komuna e Istogut me kompaninë tonë, si në vijim:

1. Ne vitin 2020 FURNIZIMI ME MATERIAL PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE KOMUNALE, ju keni lidhe kontrate me Komunen e Istogut, citoj Neni 4. Çmimi: "Kjo kontrate është e lidhur me çmime për njesi. Totali i njësive me te gjitha ngarkesat eshte 888.80euro, ndërsa vlera totale e kontratës është 45147.40euro."

2. Ne vitin 2019 NDERTIMI I SHTEPIVE PER TE PASTREHURIT NE KOMUNEN E ISTOGUT, ju keni lidhe kontrate me Komunen e Istogut, ne Formularin per dorëzimin e tenderit keni ofruar çmimin për njësi 11555.55 euro, ndërsa kontraten e keni lidh per vlerën totale 90000.00euro.

Sa i përket kontratës FURNIZIMI ME MATERIAL PER MIREMBAJTJEN E OBJEKTEVE KOMUNALE, me Komunen e Istogut, ju sqarojmë se vetë AK-ja e ka shënuar se kontrata është lidhur me çmim për njësi, prandaj po konfirmohet edhe nga vetë AK-së se kontrata duhet të lidhet me çmime për njësi. Kurse sa i përket vlerës totale të kontratës që e ka cekur, ju sqarojmë se vlera totale nuk ka qenë e garantuar e as e siguruar por në këto raste vlera totale është një tavan i vlerës së kontratës dhe në këto raste parashihen edhe plus minus 30%. Edhe paramasa në këtë projekt ka përcaktuar që çmimi të jepet për njësi dhe totali i njësive.

Sa i përket kontratës NDERTIMI I SHTEPIVE PER TE PASTREHURIT NE KOMUNEN E ISTOGUT, me Komunën e Istogut, e ku AK-së e ka cekur se ne Formularin për dorëzimin e tenderit keni ofruar çmimin për njësi 11555.55 euro, ndërsa kontratën e keni lidh për vlerën totale 90,000.00 euro, ju sqarojmë se edhe ky sqarim nuk ka të bëjë me rastin konkret sepse kjo kontratë ka qenë ndërtim i shtëpive dhe kanë qenë të përcaktuara të ndërtohen **8 shtëpi** saktë dhe ne kemi ofertuar me çmim për shtëpi dhe natyrisht që në këtë rast është ditur vlera totale e kontratës sepse është shumëzuar çmim për një shtëpi me sasinë 8 dhe është ditur vlera

e përgjithshme e kontratës. Ndërsa në këtë tender kemi kontratë kornizë me plus minus 30% e që nuk dihet saktë vlera e kontratës sepse nuk dihet se sa sasi mund të konsumohen dhe shpenzohen gjatë implementimit të kontratës, prandaj nuk mund të nënshkruhen kontratat me sasi indikative.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk ka qenë me çmim më të ulët, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe kemi ofertuar me çmim më të ulët konform paramasës.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

**VENDIM**

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e **OE "Valmir Loshi" B.I.**
**ANULOHET,** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*

*f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*

*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*